



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.17/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit B.M., avokat nga Prishtina si përfaqësues i autorizuar i KS "S....." NGA Prishtina , ndaj gjyqtarës N. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës C.nr. 162/2020, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.10.11.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit B.M., avokat nga Prishtina si përfaqësues i autorizuar i KS "S....." NGA Prishtina , ndaj gjyqtarës N. B., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtarit sipas lëndës C.nr. 162/2020.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës B.M., avokat nga Prishtina si përfaqësues i autorizuar i KS "S....." NGA Prishtina ka parashtruar Ankesë në Gjykatën Themelore në Prizren ndaj Gjyqtarës N. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr. 162/2020.

Ankuesi B.M., avokat nga Prishtina ka cekur në Gjykatën Themelore në Prizren në rrjedhë e sipër është procedura kontestimore sipas padisë së paditësit Gazmend Maloku nga Prizreni kundër të paditurës KS"S..... " NGA Prishtina të cilën e përfaqëson këtu ankuesi. Sipas ankuesit gjatë procedurës gjyqësore gjyqtarja e çështjes ka pasur veprime arbitrare dhe nuk ka pasur trajtim të barabartë të palëve dhe haptazi ka treguar njëanshmëri në menaxhimin e procesit gjyqësor duke e ndërprerë deklarinimin e ankuesit në këtë rast dhe me këtë ka cenuar të drejtën e tij për mbrojtje të interesit të kompanisë të cilën ai e përfaqëson .Më tej sipas ankuesit gjyqtarja ka cenuar parimet themelore të procedurës kontestimore duke e pamundësuar shprehjen e lirë të deklarinimit të tij duke ia tërhequr vërejtjen verbalisht dhe më pas pa kurrfarë baze ligjore me aktvendim të padrejtë duke ia shqiptuar gjobën në shumë prej 250€.Gjyqtarja ka vepruar në këtë mënyrë në dy seanca gjyqësore me dt. 27.09.2023 dhe 1 1.09.2023.Gjithashtu në procesverbalin e dt. 27.09.2023 nuk janë konstatuar në tërësi fjalët të cilat i ka thënë ankuesi dhe me këtë gjyqtarja i ka mohuar të drejtën në deklarinim dhe ka shkelur parimet themelore të procedurës kontestimore të cilat janë bazë për shkelje disiplinore për të cilën edhe ka ushtruar këtë fletëparaqitje për konstatim të përgjegjësisë së njëjtës dhe për shqiptim të masës disiplinore.

Gjyqtarja N. B., në deklaratën e saj në lidhje me pretendimet e ankuesit ka cekur se pranë kësaj gjykate është parashtruar padia e paditësit Gazmend Maloku nga Prizreni kundër të paditurës KS"S..... " NGA Prishtina për shkak të kompensimit të dëmit. Në këtë lëndë janë mbajtur dy seanca përgatitorë dhe dy shqyrtime kryesore. Gjyqtarja fillimisht ka cekur se ndien keqardhje që nuk ka pasur mundësi që seancat të incizohen dhe se në procesverbal nuk ka mundur ti paraqet të gjitha veprimet e përfaqësuesit të palës së paditur këtu ankuesit duke konsideruar se vërejtjet verbale ndaj

tij do të ndikojnë në sigurimin e rendit në gjykatë dhe mbarëvajtjen e procedurës. Respektivisht në seancën e mbajtur me dt. 27.09.2023 avokatit B.M., i ka cingëruar telefoni, i është tërhequr vërejtja ka kërkuar që të del nga seanca sepse në të njëjtën kohë ka pasur një seancë tjetër në këtë gjykatë, nuk i është lejuar dhe i është tërhequr vërejtja. Në seancën e mbajtur me cit. 11.09.2023 gjyqtarja ka deklaruar sete dy palët janë deklaruar në fjalën a tyre gjë që mund të shihet dhe të vërtetohet nga procesverbali i kësaj date. Pasi që ankuesi është deklaruar për të gjitha çështjet gjyqtarja ia ka tërhequr vërejtjen që të përmbyllë deklarinimin dhe në përgjigjen e të njëjtit se "bën vërejtje gjithë ditën e gjithë natën nuk mundesh me ma ndal të deklaroj për palën time" gjyqtarja në kuptim të nenit 288 dhe 289 të LPK-së i ka shqiptuar gjobë. Gjyqtarja gjithashtu ka deklaruar se të gjitha veprimet e saja në lidhje me përpilimin e procesverbalit kanë qenë në kuptim të nenit 137 të LPK-së. Gjyqtarja konsideron se në veprimet e saja nuk ka vepruar në mënyrë të njëanshëm , lëndën e ka trajtuar me seriozitet dhe me veprimet e saja nuk ka lejuar prishjen e rendit dhe mosrespektimin e gjykatës. Veprimet e saja kanë qenë konform dispozitave ligjore dhe parimeve të etikës gjyqësore dhe se e gjithë kjo procedurë është rrjedhë nga fakti i shqiptimit të gjobës ndaj të cilës lejohet ankesa dhe të cilën drejtë mund të shfrytëzon ankuesi.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë ndaj gjyqtarës N. B., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr. 162/2020, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes N. B., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.162/2020. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesi , avokati B.M., si përfaqësues i autorizuar i KS "S..... ka parashtruar Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës N. B., për shkak të shkeljes së rregullave të menaxhimit të procedurës gjyqësore , njëanshmërisë dhe veprimeve arbitrare gjatë deklarinimit në seancë.

Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës në rastin konkret ka konstatuar se gjyqtarja N. B., është ngarkuar me lëndën civile C.nr.162/2020 ku si paditës është G.M., nga Prizreni të cilin e përfaqëson av. B.M., nga Prizreni kurse e paditur është KS"S....." nga Prishtina të cilin e përfaqëson av. B.M., nga Prishtina në kontestin për kompensim të dëmit. Gjatë zhvillimit të procedurës janë mbajtur disa seanca dhe në dy seanca me dt. 1 1.09.2023 dhe 27 09.2023 gjyqtarja për shkak të mosrespektimit të udhëzimeve të Gjykatës ka tërhequr vërejtjen e avokatit të palës së paditur B.M., , ku edhe më pas i ka shqiptuar dënim me Gjobë. Me leximin e këtyre procesverbaleve është vërtetuar se Gjyqtarja ka respektuar rregullat e udhëheqjes së procedurës , të dy palët ndër gjygjëse kanë pasur mundësi që të deklarojnë dhe janë deklaruar. Ankuesi av. B.M., gjithashtu ka dhënë deklaratën e tij në seancë me dt. 27.09.2023 në një pasus prej 21 rreshta e cila është regjistruar në procesverbal dhe më pas është deklaruar edhe një herë pasi që gjyqtarja ia ka shqiptuar dënimin me Gjobë me një pasus tjetër prej 12 rreshta. Nga kjo është vërtetuar se gjyqtarja ia ka mundësuar që pala e paditur të deklarojë dhe nuk qëndrojnë të thënat e ankuesit se nuk ka pasur mundësi të deklarojë. Njëkohësisht i autorizuari i palës së paditur , ankuesi ka parashtruar edhe plotësim të fjalës së tij me shkrim të cilën e ka deponuar në Gjykatë është bashkangjitur në shkresa të lëndës.

Autoriteti Kompetent konsideron se gjyqtarja ka vepruar në pajtim me nenin 137.par.1 të nenit, 288 dhe 289 të LPK —së me rastin e udhëheqjes ë procedurës dhe përpilimit të procesverbalit Gjyqtarja gjykuese është e obliguar të mbajë rendin në gjykatë në mënyrë që sigurojë mirëvajtjen e seancës dhe respektimin e të drejtave të të gjithë palëve pjesëmarrëse si dhe respektimin e vet gjyqtare dhe gjykatës në tërësi. Secila palë ka të drejtë të deklarohet në seancë, por nuk ka të drejtë të keqpërdori kohën e cila i është mundësuar për deklarim , gjithsesi pala ka të drejtë të plotësojë deklarin e tij me parashtrësë me shkrim (të cilën drejtë e ka shfrytëzuar ankuesi) . Gjithashtu është konstatuara se procedura është në fillim të shqyrtimit dhe se gjatë zhvillimit dhe në fjalën përfundimtare pala ankuese do të ketë mundësi të deklarohet dhe të shpreh mbrojtjen e tij deri në përfundim të procedurës .

Andaj si Autoritet Kompetent bazuar në të lartë cekura konsideroj se gjyqtarja N. B., në veprimet e saja nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.1 nënpar.1.3 dhe nenin 5 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë trajtimi me ligj i palëve në procedurë gjatë ushtrimit të detyrës së saj zyrtare si gjyqtare.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

AD.GjThPZ nr. 17-23

Datë 10.11.2023

11.2023
Gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa Emra



paraparë e drejta e ankesës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.